



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**  
**Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice**  
**Departamenti për Profesione të Lira-Department of Freelance Professions**  
**Department of Freelance Professions**

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Committee

DPL.nr.13/2023

**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT**, në përbërje nga Manushë Karaçi kryesuesë, Adnan Konushevi dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat, \_\_\_\_\_, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore \_\_\_\_\_ lidhur me veprimet përmbarimore në lëndën përmbarimore, P.nr.630/19, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, Burbuqe Spahija-Kërveshi, pala ankuese \_\_\_\_\_ nga \_\_\_\_\_ dhe përfaqësuesi i tij avokati \_\_\_\_\_ nga \_\_\_\_\_ si dhe Përmbaruesi Privat, me datë 01.06.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. REFUZOHEN** Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-13/2023 i datës 18.04.2023 dhe ankesa e palës ankuese e datës 31.03.2023 **si të pabazuara.**

**II.** Përmbaruesi Privat \_\_\_\_\_, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore \_\_\_\_\_ nuk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbarimore, P.nr.630/2019.

**A r s y e t i m**

Me datën 31.03.2023 pala ankuese ka parashtuar ankesë, të cilën e ka plotësuar me datën 18.04.2023, me pretendimin se përmbaruesi privat \_\_\_\_\_, nuk ka vepruar për kryerjen e veprimeve përmbarimore që kanë pasur për qëllim dorëzimin e paluajtshmërisë lëndore tek kreditori.

Sipas palës ankuese si kreditor tek përmbaruesi privat është inicuar rasti duke u bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës që i plotëson kushtet si dokument përmbarues, pasi vendimi ka qenë i

plotëfuqishëm dhe i ekzekutueshëm. Sipas vendimit të gjykatës debitorët kanë qenë të obliguar që të lirojnë paluajtshmërinë lëndore dhe të njejtën t ia dorëzojnë kreditorit.

Pala ankuese në vazhdim ka theksuar se debitorët i kanë shfrytëzuar mjetet juridike të parapara në procedurën përbarimore dhe gjykata fillimisht e ka refuzuar prapësimin, ndërsa gjykata e shkallës së dytë e ka refuzuar edhe ankesën duke lënë në fuqi urdhërin e përbaruesit në këtë lëndë.

Pala debitore është lajmëruar në zyre të përbaruesit me kërkesën që të shtyhet dorëzimi i paluajtshmërisë lëndore me arsyetimin se ka të mbjellura në atë paluajtshmëri dhe me qëllim që të vilet fryti atë vit si dhe kanë inicuar rast në Gjykatën Supreme, duke kërkuar që edhe të pritët mos Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme do të vendos lidhur me padinë e tyre.

Si kreditor i janë drejtuar përbaruesit që të dilet në vend për dorëzim të paluajtshmërisë, pasi nuk kishte asnjë pengesë ligjore në këtë drejtim.

Përbaruesi ka caktuar dalje në terren dy herë, me qëllim konstatimi mos debitorët kanë bërë dorëzim vullnetar, mirëpo asnjëherë nuk është realizuar dalja.

Me konkluzionin e fundit për dalje në terren sipas përbaruesit është caktuar dalja me datën 08.11.2022 në ora 10.00, mirëpo përsëri është shtyer, të gjitha këto sipas palës ankuese me lëshimet e vet përbaruesit privat.

Përkundër kërkesës së fundit që i është parashtruar përbaruesit përmes postës elektronike nga ana e kreditorit për dalje në teren me datën, 17.01.2023, përbaruesi prapë nuk ka vepruar.

Duke u bazuar në këto si palë ankuese kanë parashtruar ankesë me pretendimin se përbaruesi ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 284 dhe nenit 367, par. 1, pika 1.2 dhe 1.4 të LPP-së.

**I kanë propozuar komisionit që të ndërmerren masa ndaj përbaruesit privat dhe të shqiptohet masa nga neni 368 i LPP-së, ndalim i ushtrimit të profesionit nga 3 muaj deri në një vit ose shkarkim nga detyra.**

Me datën 18.04.2023, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përbarimin Privat, ka paraqitur në Komision Raportin Përfundimtar ndaj përbaruesit privat, lidhur me veprimet përbarimore për këtë lëndë.

Përbaruesi Privat, në deklaratën e tij ka parashtruar se pas pranimit të propozimit për përbarim, të njejtën ditë edhe janë ndërmarrë veprimet dhe është lejuar përbarimi. Pasi palët kanë ushtruar mjetet juridike, menjëherë pas refuzimit të prapësimin nga gjykata, përbaruesi e kishte caktuar daljen në terren, sipas kërkesës së kreditorit dhe bazur në dispozitat e nenit 284 par.2 të LPP-së.

Pasi përbaruesi ka ndërmarrë veprimet e duhura për dalje në terren, duke siguruar asistencën edhe të policisë, pala debitore ka kërkuar që përbarimi të shtyhet, pasi kanë parashtruar ankesë ndaj vendimit mbi prapësimin. Për këtë është njoftuar edhe pala kreditore dhe nuk e ka kundërshtuar shtyerjen derisa të vendos gjykata lidhur me ankesën.

Ditën e caktuar për dalje në terren, përbaruesi ka theksuar se janë takuar me zyrtarët policor dhe gjatë tentimit të takimit me debitorët në adresat e tyre është vërejtur një numër i konsiderueshëm i qytetarëve, të cilin ish-in mbledhur për këtë rast dhe duke pasur parasysh këtë situatë, nuk është bërë fare takimi me debitorët, por për shtyerjen i ka njoftuar përmes telefonit.

Me datën 28.04.2021 dhe 04.05.2021, përmbauesi i është drejtuar zyrës së Kryeministrit të Kosovës, me kërkesë për sqarim se si të veprohet lidhur me këtë rast, pasi rasti kishte të bënte me pronat që ndërlidhen me veprimtarinë e AKP-së, por nuk kishte pasur asnjë përgjigje.

Pas kësaj lënda është kthyer nga Gjykata e Apelit dhe pasi vendimi i gjykatës së shkallës së dytë ka lënë në fuqi vendimin e asaj të shkallës së parë, si përmbaues me kërkesë të kreditorit kishte caktuar daljen në teren për datën 27.05.2021, duke caktuar ekspertët gjeodet dhe kërkuar asistencën e policisë.

Me datën 24.05.2021, në zyre të përmbauesit gojarisht nga ana e debitorëve është kërkuar shtyerja e përbarimit për të cilën është përpiluar shënim zyrtar.

Me datën 25.05.2021 është mbajtur shënim zyrtar në zyre të përmbauesit me kreditorët, ku u është bërë me dije kërkesa e debitorëve për shtyerje dhe përbarimi është shtyer deri në fund të muajit Korrik 2021.

Përmbauesi më tutje ka theksuar se me kërkesë të kreditorit është caktuar dalja në teren për datën 28.09.2021. Në ndërkohe ka pranuar nga debitorët kërkesën për shtyerje me arsyetimin që debitorët kanë parashtruar një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese dhe deri sa të pranojnë një vendim nga Gjykata Kushtetuese, të shtyhet përbarimi. Gjithashtu përmes emailit nga 24.09.2021, nga Policia e Kosovës, përmbauesi është njoftuar që për shkak të situatës së krijuar në , për datën e caktuar për teren, policia nuk mund të asistojnë.

Me datën 18.11.2021, debitorët kanë parashtruar kërkesë për përjashtim të përmbauesit, të cilës kërkesë për përjashtim i është bashkangjitur edhe vet përmbauesi për shkak të gjendjes së tij shëndetësore, pasi ka pasur një ndërhyrje kirurgjikale dhe ende nuk ishte në gjendje të mirë fizike që të përballet me veprimet që duhej ndërmarrë, sepse kishte për të liruar sipërfaqen prej 117 hektarësh. Për këtë gjendje shëndetësore ka qenë i njoftuar edhe vet kreditori.

Përmbauesi në vazhdim ka theksuar se pas refuzimit të kërkesës për përjashtim të përmbauesit, i njëjti ka ndërmarrë veprimet dhe ka caktuar daljen në teren për datën 08.11.2022, ku edhe është bërë kërkesa për asistim në policinë e Kosovës .

Nga komandanti i policisë, përmes emailit me datën 07.11.2022, përmbauesi është njoftuar se policia nuk mund të asistoj për datën 08.11.2022, për shkak të angazhimeve të tyre dhe kjo ishte hera e dytë që për shkak të mos asistencës policore, është shtyer përbarimi, me të njëjtin arsyetim për shkak të situatës në veri të vendit.

Gjatë kësaj kohe kreditori është njoftuar vazhdimisht edhe përkundër që përmbauesi ka pasur dy intevenime shëndetësore, si përmbaues i njëjti ka ndërmarrë veprime dhe nuk ka pasur neglizhencë gjatë kryerjes së punës së tij..

Në seancën dëgjimore palët kanë mbetur në tërësi sikurse në kërkesat e tyre të mëhershme. Përfaqësuesi i palës ankuese ka deklaruar se kanë inicuar procedurë disiplinore ndaj Përmbauesit Privat për faktin se përmbauesi privat gjatë ndërmarrjes së veprimeve përbarimore ka bërë shkelje të Ligjit për Procedurën Përbarimore , pasi i njëjti me veprimet e tij konkretisht me mosveprimin e tij dhe në bashkëpunim me palët debitorë është duke i shkaktuar dëm të pariparueshëm kreditorit . Procedura përbarimore është inicuar me dt. 03.09.2019, debitorët kanë paraqitur prapsim brenda afatit ligjor, se gjykata e ka refuzuar prapësimin e debitorëve dhe po të njëjtit debitor kanë ushtruar ankesë ndaj vendimit të gjykatës, gjë që edhe

ankesa e debitorëve është refuzuar nga Gjykata e Apelit, edhe pse Përmbauesi Privat konform dispozitave ligjore të Ligjit për Procedurën Përmbaimore, nuk ka pasur nevojë të pret vendimin e Gjykatës së Apelit, pasi i njëjti nuk ka dalur në teren për zbatimin e urdhrit përmbaimor.

Meqenëse me kërkesë të tij personale ka kërkuar nga kreditori që lirimi i palujtshmërive të bëhet pas të korrurave në korrik të vitit 2021, pëlqimi i dhënë nga kreditori ishte që kjo palujtshmëri të lirohet. Në vazhdim ka theksuar se nga viti 2021 e tutje në mënyrë të vazhdueshme i është kërkuar përmbauesit të ndërmer veprime të duhura ligjore me qëllim të liritimit të palujtshmërive sipas propozimit për përmbaim. Përmbauesi me qëllim i ka udhëzuar palët debitore që të kërkojnë përjashtimin e tij nga kjo procedurë përmbaimore dhe përmbauesi i është bashkangjitur kërkesës së debitorëve që të përjashtohet nga kjo procedurë përmbaimore, gjë që gjykata e ka refuzuar kërkesën e përbashkët të tyre.

Në mënyrë të vazhdueshme me email me prezencë fizike në zyrën e tij, kreditori me përfaqësuesin e tij ka kërkuar që të ndërmer veprimet e duhura përmbaimore. Kërkesat për asistencë nga policia të bëra nga përmbauesi, janë bërë në kohën kur ky ishte i bindur që policia e Kosovës nuk mund të ju ofronte asistencë, e kjo vërtetohet me faktin që të dy rastet që i është drejtuar policisë, është kur policia kishte angazhim shtesë në Veriun e Kosovës. Andaj, ka kërkuar nga komisioni që të ndërmer masën disiplinore konform kërkesës së paraqitur, ndalimi i ushtrimit të profesionit nga 3 muaj deri në një vit ose shkarkim nga detyra, pasi i njëjti në mënyrë të vazhdueshme është duke e shkelur Ligjin e procedurës përmbaimore duke i favorizuar debitorët në këtë rast.

Përmbauesi privat në seancë lidhur me pretendimet e të autorizuarit të kreditorit në kërkesën për procedurën disiplinore ndaj tij si përmbaues ka deklaruar se ka dhënë deklaratë dhe e ka shpjeguar në tërësi rrjedhën e lëndës dhe veprimet e ndërmarra deri më tani pavarësisht se ende nuk është arritur qëllimi, përkatësisht zbatimi i përmbaimit. Është e vërtetë se ka pranuar lëndën me dt.03.09.2019, të njëjtën ditë është lejuar përmbaimi në bazë të aktgjykimit si dokument përmbaimor, se brenda afatit ligjor palët kane ushtruar prapësim dhe pas pranimit të përgjigjes nga kreditori, lënda është përcjellur në Gjykatën Themelore dega për vendosje. Më tutje, përmbauesi ka sqaruar se Gjykata Themelore ka marrë vendim me datën 18.10.2019, dhe se ndaj aktvendimit për refuzimin e prapësimit, ka pasur ankesë dhe lënda ka vazhduar sipas ankesës në Gjykatën e Apelit.

Përmbauesi poashtu ka shtuar se nuk qëndrojnë pretendimet e të autorizuarit të kreditorit për mos ndërmarrjen e veprimeve deri në vendosjen e ankesës. Këtë e vërtetoi me faktin se me Konkluzionin e datës 22.11.2019 është caktuar dalja në teren për datën 11.12.2019 dhe kjo dalje është realizuar. Është procesverbalë si në shkresat e lëndës, sipas të cilit përmbaimi është shtyer sipas kërkesës së debitorëve dhe me aprovimin e kreditorit. Gjykata e Apelit lidhur me ankesën ndaj aktvendimit mbi prapësimin ka vendosur me dt. 06.04.2020, ndërsa dalja ishte e caktuar në muajin nëntor 2019. Pas pranimit të lëndës nga Gjykata e Apelit është njoftuar se ka qenë periudha e pandemisë viti 2020, dhe ka qenë e pamundur për shkak të periudhave të mbyllura që të organizohet dalja në teren. Përveç kësaj kreditori e dinte se në muajin mars 2020, përmbauesi ka pasur një intervenim kirurgjik dhe ka qenë pengesë gjendja e tij shëndetësore.

Kjo është potencuar vazhdimisht me kreditorin por që në realitet mos zbatimi i përmbaimit fare nuk kishte të bënte me gjendjen shëndetësore të përmbauesit, pasi i njëjti maksimalisht është përpjekur për zbatimin e përmbaimit. Lidhur me kërkesën për përjashtim të ushtruar nga debitorët, i autorizuari i kreditorit, ka theksuar se i është bashkangjitur kërkesës me shkrim për përjashtim me arsyetimin se gjendja shëndetësore është pengesë dhe do të ishte mirë edhe për kreditorët të

vazhdohet përmbarimi në ndonjë zyre tjetër përmbarimore. Kjo nga se në ndërkohë, i njeiti i është nënshtruar edhe një intervenimi tjetër kirurgjik, por pa sukses edhe i dyti, për shkak se kreditori është njoftuar personalisht dhe për këtë çështje kanë biseduar në zyrën e tij për çka edhe iu ka thënë nëse gjykata refuzon kërkesën për përjashtim dhe nëse do të kenë asistencën e policisë dhe përmbaruesit do t' i përmirsohet gjendja shëndetësore, do të ndërmerren veprimet. Të gjitha këto janë sipas konkluzionit të marrë për dorëzim e lirim të palujtshmërisë të datës 11.05.2021 edhe kjo dalje është shtyrë me kërkesën e kreditorit. Me datën 24.05.2021 është shtyer me kërkesën e kreditorit sipas shënimit zyrtar. Me datë 15.09.2021 është konkluzioni i tretë i radhës i cili është shtyer për shkak të situatës në Veri. Dalja ka qenë e caktuar për datë 28.09.2021 dhe ka qenë e pamundur të imagjinohet e ardhmja dy javë përpara. Dalja e katërt është caktuar me datën 13.10.2022 edhe kjo është shtyer për shkak të gjendjes në veri.

Pas seancës dëgjimore, dëgjimit të palëve, Komisioni Disiplinor me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar se në këtë rast Përmbaruesi Privat, nuk është përgjegjës për asnjërën nga shkeljet disiplinore të përcaktuara me nenin 367 të LPP-së,

Këtë konstatim komisioni e bazon në provat dhe shkresat e lëndës, ku janë përshkruar veprimet përmbarimore në këtë rast. Dokumentin përmbarimor që është Aktgjykimi i Gjykatës, vendimet e gjykatave lidhur me mjetet juridike dhe kërkesat e parashtruara nga palët, komunikimi i zyrës së përmbaruesit me palët dhe institucionet tjera si dhe policinë e Kosovës.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

## KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT

DPL.nr.13/2023 datë 01.06.2023

Kryesuesja e Komisionit Disiplinor  
Manushe Karaci



**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqurka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.